



FLETORJA ZYRTARE

E

REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

Nr. 50

2003

Qershor

P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Vendim i KM nr.352, datë 5.6.2003	Për miratimin e programit dhe të dokumentacionit të projektit, për realizimin e kontratës koncesionare për Aeroportin Ndërkombëtar “Nënë Tereza” Rinas, Tiranë	1963
Vendim i KM nr.360, datë 5.6.2003	Për miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, që transferohen në pronësi të Bashkisë së Librazhdit.....	1963
Vendim i KM nr.361, datë 5.6.2003	Për miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, që transferohen në pronësi të Komunës së Maminasit.	1964
Vendim i KM nr.362, datë 5.6.2003	Për miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, që transferohen në pronësi të Bashkisë së Himarës	1965
Vendim i KM nr.370, datë 5.	Për miratimin e strategjisë “Për shërbimin e radiondërlidhjes detare në Republikën e Shqipërisë”.....	1966
Vendim i KM nr.371, datë 5.6.2003	Për miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, që transferohen në pronësi të Bashkisë së Kuçovës	1972

Vendim i KM nr.377, datë 12.6.2003	Për miratimin e programeve të ristrukturimit, në funksion të privatizimit të INSIG-sh.a.....	1973
Vendim i KM nr.378, datë 12.6.2003	Për pagesën nga fondet e INSIG-sh.a. të shpenzimeve që do të bëhen nga IFC-ja dhe BERZH-i në funksion të privatizimit të INSIG-sh.a.....	1976
Vendim i KM nr.381, datë 12.6.2003	Për shpërblimin e anëtarëve të Këshillit të Lartë të Drejtësisë.....	1977
Vendim i KM nr.391, datë 12.6.2003	Për fillimin e procedurës së dhënies me koncesion të formës “ROT” të hidrocentralit të Gjançit në Korçë.....	1977
Vendim i KM nr.392, datë 12.6.2003	Për miratimin e statutit të Agjencisë së Nxitjes së Eksporteve (ANE).....	1978
Vendim i KM nr.393, datë 12.6.2003	Për një shtesë në vendimin nr.151, datë 25.4.2002 të Këshillit të Ministrave “Për statusin “Dëshmor i Atdheut””	1984
Vendim i KM nr.394, datë 12.6.2003	Për kalimin në administrim të Bashkisë së qytetit të Korçës të ish-shtëpisë së ushtarakëve në këtë qytet.....	1984
Udhëzim i MRRTT nr.4, datë 11.6.2003	Mbi prioritetet e trajtimit të familjeve që kanë humbur banesat nga rënia e skemave piramidale.....	1985
Udhëzimi Bankës së Shqipërisë	Për mënyrën e zbatimit të ekzekutimit të detyrimeve mbi shumat e llogarive në banka	1986
	Kërkesë për shpronësim të objektit “Rikonstruksion i varrezave të Sharrës në Tiranë”.....	1989
	<i>Vendim i shkurtuar</i> për shpalljen të zhdukur të shtetasit Liman Bajram Spahiu.	1989
	<i>Vendim i shkurtuar</i> për shpalljen të zhdukur të shtetasit Paqësor Dilaver Ismailaj	1989
	<i>Kërkesë</i> për shpallje të zhdukur të shtetasit Leonidha Hida	1990

V E N D I M
Nr.352, datë 5.6.2003

**PËR MIRATIMIN E PROGRAMIT DHE TË DOKUMENTACIONIT TË PROJEKTIT, PËR
REALIZIMIN E KONTRATËS KONCESIONARE PËR AEROPORTIN NDËRKOMBËTAR
“NËNË TEREZA” RINAS, TIRANË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 5 të ligjit nr.7973, datë 26.7.1995 “Për koncesionet dhe pjesëmarrjen e sektorit privat në shërbimet publike dhe infrastrukturë”, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë dhe të Ministrit të Transportit dhe të Telekomunikacionit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Miratimin e programit dhe të dokumentacionit të projektit që i bashkëlidhet këtij vendimi, për realizimin e kontratës koncesionare, për fazën konkurruese të tenderit për Aeroportin Ndërkombëtar “Nënë Tereza”, Rinas si më poshtë vijon:

- a) memorandum i informativ, volumi I;
- b) instruksionet për tenderin, volumi II;
- c) termat e Kontratës, volumi III.

2. Ngarkohet Ministria e Ekonomisë dhe Ministria e Transportit dhe e Telekomunikacionit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

V E N D I M
Nr.360, datë 5.6.2003

**PËR MIRATIMIN E LISTËS PARAPRAKE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME PUBLIKE,
QË TRANSFEROHEN NË PRONËSI TË BASHKISË SË LIBRAZHBIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22. 2. 2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, me propozimin e Ministrit të Pushtetit Vendor dhe të Decentralizimit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi të Bashkisë së Librazhdit, sipas tabelës, që i bashkëlidhet këtij vendimi. Kjo listë paraprake, sipas kërkesave të këshillit bashkiak të Librazhdit, është pjesë e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, që janë brenda juridiksionit territorial dhe administrativ të Bashkisë së Librazhdit, miratuar me vendimin nr.102, datë 20.2.2003 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore në Bashkinë e Librazhdit”.

2. Pronat me numër rendor inventari nga 9 në 15, të vazhdojnë të përdoren nga përdoruesit e sotëm, në bazë të aktmarrëveshjeve ose të rregullimeve të tjera ligjore ndërmjet tyre dhe Bashkisë së Librazhdit.

3. Ngarkohet Ministria e Pushtetit Vendor dhe e Decentralizimit dhe Bashkia e Librazhdit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

Lidhja 1

Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit	Fushat e përdorimit të pronës
9-15	Zyra të partive politike që ndodhen në ndërtesën ebashkisë dhe në ndërtesën e bibliotekës
26-49	Prona që përdoren për realizimin e programeve arsimore
50-51 dhe 108	Prona që përdoren për realizimin e veprimtarive social-kulturore
52-53 dhe 109-110	Monumente historike e kulturore dhe buste me interes vendor
54-72 dhe 74	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në shëndetin publik
17,83,103 dhe 420	Prona për shërbime të ndryshme
104-107	Prona që përdoren për realizimin e veprimtarivesportive
111-113	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve sociale
114-138	Prona që përdoren për strehim dhe mbrojtje civile
139-366, 369 dhe 418	Infrastrukturë vendore dhe shërbime publike.
367-368	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve ekonomike
370- 371	Troje dhe hapësira publike
372-373	Rrugë vendore dhe rrjeti i ndriçimit publik
419, 421-422	Prona për shërbime të pastrim-gjellbërimit

V E N D I M Nr.361, datë 5.6.2003

PËR MIRATIMIN E LISTËS PARAPRAKE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME PUBLIKE, QË TRANSFEROHEN NË PRONËSI TË KOMUNËS SË MAMINASIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, me propozimin e Ministrit të Pushtetit Vendor dhe të Decentralizimit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi të Komunës së Maminasit, sipas tabelës që i bashkëlidhet këtij vendimi. Kjo listë paraprake, sipas kërkesave të këshillit të komunës së Maminasit, është pjesë e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, që janë brenda juridiksionit territorial dhe administrativ të Komunës së Maminasit, miratuar me vendimin nr.103, datë 20.2.2003 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore të Komunës Maminas”.

2. Ngarkohet Ministria e Pushtetit Vendor dhe e Decentralizimit dhe Komuna e Maminasit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Lidhja 1

Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit	Fushat e përdorimit të pronës
1-12	Prona që përdoren për realizimin e programeve arsimore
13-20	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në shëndetin publik
28-30	Monumente historike e kulturore dhe buste me interes vendor
31-55	Varreza publike
56	Prona që përdoren për mbrojtjen civile
57-66 (vetëm rrjeti terciar)	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (ujtje kullim)
82	Ujësjetlla të veçantë të fshatrave
83	Sistemi i kanalizimeve të ujërave të zeza
85-86	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit
87-92	Rrugë vendore
93-95	Troje dhe hapësira publike
96	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e zhvillimit ekonomik

V E N D I M
Nr.362, datë 5.6.2003

**PËR MIRATIMIN E LISTËS PARAPRAKE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME PUBLIKE,
QË TRANSFEROHEN NË PRONËSI TË BASHKISË SË HIMARËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 3 e 17 të ligjit nr. 8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, me propozimin e Ministrit të Pushtetit Vendor dhe të Decentralizimit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi të Bashkisë së Himarës, sipas tabelës, që i bashkëlidhet këtij vendimi. Kjo listë paraprake sipas kërkesave të këshillit bashkiak të Himarës, është pjesë e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, që janë brenda juridiksionit territorial dhe administrativ të Bashkisë së Himarës, miratuar me vendimin nr.101, datë 20.2.2003 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore në Bashkinë e Himarës”.

2. Ngarkohet Ministria e Pushtetit Vendor dhe e Decentralizimit dhe Bashkia e Himarës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

Lidhja 1

Numërat rendorë të pronave në listën e inventarit	Fushat e përdorimit të pronës
6-18	Prona që përdoren për realizimin e programeve arsimore
19-22	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në shëndetin publik
33,35-41	Prona që përdoren për realizimin e veprimtarive social-kulturore e sportive
42-48	Monumente historike e kulturore dhe buste me interes vendor
49-61	Varrezat publike
62	Grumbullim, depozitim i mbeturinave të ngurta
63-74	Prona që përdoren për strehim dhe mbrojtje civile
85-86	Prona që përdoren si lehtësira të transportit vendor
90-91 (përfshi truallin dhe godinën e stac. të pompimit nr.1 dhe nr.2 dhe tubacionet e dërgimit brenda zonës kadastrale nr.1992)	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit
96,100	Ujësjiellsa të veçantë të fshatrave
105-110	Rrugë vendore dhe rrjeti i ndriçimit publik
111-112	Troje dhe hapësira publike
245-247, 281, 282, 285-302, 305-319	Pyje, kullota shkëmbore që përdoren për interesa vendore

V E N D I M
Nr.370, datë 5.6.2003

PËR MIRATIMIN E STRATEGJISË “PËR SHËRBBIMIN E RADIONDËRLIDHJES DETARE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 4 pikat 1 e 5 të ligjit nr. 8618, datë 14.6. 2000 “Për telekomunikacionin në Republikën e Shqipërisë” dhe të nenit 1 të ligjit nr.8430, datë 14.12.1998 “Për ratifikimin e Kushtetutës dhe të Konventës së Bashkimit Ndërkombëtar të Telekomunikacionit, ITU (Gjenevë, 1992)”, me propozimin e Ministrit të Transportit dhe të Telekomunikacionit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Miratimin e strategjisë “Për shërbimin e radiondërlidhjes detare në Republikën e Shqipërisë”, që i bashkëlidhet këtij vendimi.
 2. Ngarkohet Ministria e Transportit dhe e Telekomunikacionit dhe Enti Rregullator i Telekomunikacioneve për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

STRATEGJIA
PËR SHËRBBIMIN E RADIONDËRLIDHJES DETARE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË

I. PLANIFIKIMI DHE HARMONIZIMI I RADIOFREKUENCAVE

Brezat e frekuencave për shërbimin e radiondërlidhjes detare janë të përcaktuara në planin

kombëtar të radiofrekuencave në përputhje me përcaktimet e radio rregulloreve të Bashkimit Ndërkombëtar të Telekomunikacionit (ITU).

Drejtoria e Përgjithshme e Postë Telekomunikacioneve (DPPT) do të bashkërendojë punën për planifikimin kombëtar të radiofrekuencave dhe për harmonizimin e tyre me standardet ndërkombëtare duke ndjekur zbatimin e detyrimeve që ka administrata shqiptare kundrejt marrëveshjeve dhe konventave rajonale dhe ndërkombëtare lidhur me operimin e shërbimit të radiondërlidhjes detare.

II. LICENCIMI

Kategoritë kryesore të licencave për këtë shërbim janë:

1. Licencë për stacionet radio të anijeve
2. Licencë për radio portabël të anijeve
3. Licencë për stacionet radio bregdetare

Për çdo stacion licenca do të përmbajë edhe shenjën e thirrjes, e cila përbën një identifikim unik për stacionin. Shenja e thirrjes së bashku me të dhënat e tjera të stacionit radio bregdetar ose të një mjeti lundrues regjistrohen nga ERT-ja në ITU, nëpërmjet të cilës u bëhen të njohura administratave të tjera. ERT-ja ka për detyrë të njoftojë menjëherë ITU-në për çdo ndryshim në të dhënat e një mjeti lundrues. Në rastin e përdorimit të pajisjeve radio të sistemit DSC dhe të shërbimeve satelitore, stacionit radio i caktohet dhe numri MMSI (Identifikimi i shërbimit të lëvizshëm detar). ERT-ja bën regjistrimin e MMSI në ITU.

1. Licenca për stacionet radio të anijeve

Mjetet e lundrimit, të regjistruara në Republikën e Shqipërisë dhe të detyruara nga autoritetet e lundrimit detar për të pasur në bord pajisje radiokomunikimi duhet të pajisen me licencë për përdorimin e stacionit radio.

Licencat për stacionet radio të anijeve duhet të përmbajë kushtet e mëposhtme:

a) Shërbimi i stacionit radio të anijes të vendoset nën autoritetin e pronarit ose kapitenit të anijes.

b) Pronari ose kapiteni të kërkojë që çdo person që përdor stacionin radio të anijes të veprojë në përputhje me rregulloren e nxjerrë nga ERT-ja dhe radio rregulloret e Bashkimit Ndërkombëtar të Telekomunikacioneve (ITU).

c) Në rastin e përdorimit të frekuencave ndërkombëtare, personi përgjegjës për stacionin radio të anijes të jetë i pajisur personalisht ose të mbikëqyrët nga dikush që është i pajisur me certifikatën e operatorit radiodetar.

d) Pronari ose kapiteni është përgjegjës për sigurimin e sekretit të informacionit të marrë nëpërmjet shërbimit të radiokomunikacionit.

e) Stacionet radio të anijeve të plotësojnë standardet e miratuara nga Enti Rregullator i Telekomunikacioneve.

2. Licenca për stacionin radio portabël të anijeve

Licenca për stacionin radio portabël të anijeve jepet për stacionin radio të anijes, i cili nuk instalohet në mënyrë të përhershme në mjetin lundrues. Kjo licencë nxirret për një stacion radio anijeje që përdoret në më tepër se një mjet lundrues.

Stacionet radio portabël të anijeve përdorin kanale ndërkombëtare dhe si rrjedhim personi që përdor pajisjen radio duhet të jetë i pajisur personalisht ose të vëzhgohet nga dikush që është i pajisur me certifikatën e operatorit radiodetar.

3. Licenca për stacionet radio bregdetare

Licenca ndërkombëtare

Licenca ndërkombëtare jepet për stacionet bregdetare të porteve me qëllim sigurimin e komunikimeve lidhur me operimet portuale dhe lëvizjen e anijeve. Kjo licencë mbulon vetëm stacionin bregdetar. Mjetet lundruese, të cilave u ofrohet shërbim nga ky stacion bregdetar, duhet të pajisen me licenca për stacion radio anijeje. Në këtë rast përdoren kanale ndërkombëtare dhe si rrjedhim personi përgjegjës për stacionin duhet të jetë i pajisur personalisht ose të vëzhgohet nga dikush që është i pajisur me certifikatën e operatorit radiodetar. Stacionet radio bregdetare mund të interkonektohen me rrjetin publik telefonik për të realizuar komunikimin ndërmjet anijeve dhe përdoruesve të rrjeteve telefonike tokësore.

- b) Licenca "Klub lundrimi"

Licenca jepet për klubet e lundrimit, jahtet ose organizatat e ngjashme me qëllim sigurimin e

komunikimeve që kanë të bëjnë me lëvizjen dhe ankorimin e mjeteve lundruese për qëllime argëtimi. Në këtë rast, janë të disponueshme tre kanale, të cilat janë unike për këtë lloj licence. Dy prej tyre janë kanale kombëtare simplekse. Meqenëse këto kanale radiodetare nuk janë ndërkombëtare, përdoruesi nuk detyrohet të pajiset me certifikatën e operatorit radiodetar. Në këtë rast, licenca mbulon stacionin bregdetar dhe mjetet e lundrimit që ky stacion u ofron shërbim.

Licenca mund të përmbajë si opsion përdorimin e një kanali ndërkombëtar. Në këtë rast mjetet lundruese që do të transmetojnë në këtë kanal duhet të kenë licencën për stacionin radio anije dhe operatori i pajisjes radio duhet të jetë i pajisur me certifikatën e operatorit radiodetar.

c) Licenca kombëtare

Licenca kombëtare jepet për subjektet që komunikojnë me mjetet e tyre të lëvizshme për çështje tregtare duke përdorur një kanal detar privat.

Kanalet e dhëna për këtë shërbim janë kanale detare kombëtare dhe si rrjedhim nuk kërkojnë përdorues të pajisur me certifikatën e operatorit radiodetar. Licenca kombëtare mbulon stacionin bregdetar dhe mjetet e lundrimit që shërbehen nga ky stacion.

Mjetet e lundrimit duhet të pajisen me licencë radio anijeje vetëm kur stacioni radio që ato disponojnë transmeton në kanale detare ndërkombëtare. Në këtë rast, personi përgjegjës për stacionin radio anijeje duhet të jetë i pajisur ose të vëzhgohet nga dikush që është i pajisur me certifikatën e operatorit radiodetar.

Stacionet radio bregdetare mund të interkonektohen me rrjetin publik telefonik për të realizuar komunikimin ndërmjet anijeve dhe përdoruesve të rrjeteve telefonike tokësore.

d) Licenca të përkohshme

Tre llojet e mësipërme të licencave mund të jepen nga ERT-ja si të përkohshme. Licencat e përkohshme janë të vlefshme për një periudhë kohe deri në tre muaj.

III. CERTIFIKIMI I OPERATORIT RADIODETAR

Shërbimi i çdo stacioni radio anijeje dhe stacioni radio bregdetar, licencuar për transmetimin në kanalet detare ndërkombëtare duhet të jetë i kontrolluar nga një person i pajisur me një certifikatë operatori radiodetar. Procedurat për testimin dhe certifikimin hartohen nga ERT-ja.

Certifikata e operatorit radiodetar, përveç të tjerash, përmban të dhënat e mëposhtme:

- emrin, datëlindjen dhe firmën e mbajtësit të certifikatës;
- titullin e certifikatës dhe datën e lëshimit;
- kohëzgjatjen e certifikatës;
- emrin e autoritetit që lëshon certifikatën;
- fotografinë e mbajtësit të certifikatës.

Për të lehtësuar verifikimin, certifikata shkruhet në dy gjuhë, në gjuhën shqipe dhe në një nga gjuhët e punës së ITU-së.

Procedurat e testimit sigurojnë që përdoruesit e stacioneve radio zotërojnë njohuritë e nevojshme për përdorimin e pajisjeve të tyre dhe kanë njohuri për procedurat e thirrjeve në përgjithësi dhe në veçanti për procedurat e përdorura si në situata fatkeqësie dhe shpëtimi, të përcaktuara në rregulloren ndërkombëtare.

IV. AUTORITETI I LLOGARIVE DETARE

Autoriteti i llogarive detare është një agjenci operuese ose një ent i licencuar nga ERT-ja që operon në përputhje me përcaktimet e shtojcës 2 të ITR-së dhe rekomandimit D.90 të ITU-T, tek i cili dërgohen faturat në lidhje me stacionet e lëvizshme detare.

Autoriteti i llogarive detare vepron si një ndërmjetës ndërmjet pronarëve të anijeve dhe ofruesve të shërbimit dhe lehtëson grumbullimin dhe shpërndarjen efektive të pagesave për llogari të thirrjeve radiotelefonike dhe telekse joemergjente të anijeve.

Autoriteti i llogarive detare, ndër të tjera është përgjegjës për:

- mbledhjen e pagesave për llogari të thirrjeve radiotelefonike dhe telekse joemergjente të kryera nga anijet për të cilat autoriteti i llogarive detare ka përgjegjësi;
- shlyerjen e detyrimeve ndaj ofruesve të shërbimit për trafikun e realizuar nga anijet, për të cilat ky autoritet i llogarive detare është përgjegjës, duke siguruar që këto pagesa të bëhen në përputhje me rregulloren dhe rekomandimet e ITU-së;
- reduktimin e llojeve të faturave dhe pagesave që kalojnë përmes ofruesve të shërbimit dhe të pronarëve të anijeve;

- sigurimin e një shërbimi të vazhdueshëm mbarë botëror për pajtimtarët detarë;
- sigurimin e burimeve për kryerjen e ekspertizave të nevojshme për të trajtuar kompleksitetin e faturimit për trafikun detar ndërkombëtar;

- njoftimin e ofruesit të shërbimit për pajtimtarët e rinj dhe për ndonjë ndryshim në statusin e pajtimtarëve detarë ekzistues p.sh., një ndryshim në pronarin, flamurin dhe ose në përfundimet e kontratës;

- sigurimin e freskimit të listave të pajtimtarëve detarë për ofruesit e shërbimit dhe botimin e listave të reja të paktën çdo 90 ditë me të gjitha ndryshimet përkatëse.

1. Licencimi i autoriteteve të llogarive detare

ERT-ja licencon dhe pajis me kodin e indentifikimit (AAIC) çdo autoritet të llogarive detare, që mban llogaritë e mjeteve shqiptare të lundrimit.

Asnjë autoriteti të llogarive detare nuk mund t'i jepet më shumë se një AAIC. AAIC-ja nuk mund të rijepet, shitet, shkëmbehet ose transferohet, në rastin e shitjes së autoritetit të llogarive detare, pa miratimin me shkrim të ERT-së.

Licencat për autoritetet e llogarive detare duhen të trajtohen mbi bazën e parimit “kush vjen i pari, shërbehet i pari”.

Autoritetet e llogarive detare duhet të kenë procedura për zgjidhjen e ankesave dhe kërkesave nga klientët kontraktues të tyre (mjetet e lundrimit për të cilat ai kryen pagesat, ofruesit e shërbimit), nga ERT-ja, ITU-ja dhe administratat e huaja ose agjentët e tyre.

2. Raportimi

Çdo autoritet i llogarive detare duhet të krijojë llogaritë e tij jo më vonë se gjashtë muaj nga data e licencimit, në të kundërt ERT-ja pezullon licencën.

Brenda 60 ditëve pas licencimit, autoriteti i llogarive detare duhet t'i sigurojë ERT-së një listë fillestare të mjeteve të lundrimit, për të cilat ai ofron shërbim. Kjo listë duhet të përmbajë vetëm mjetet lundruese, së bashku me shenjat e tyre të thirrjes, të regjistruara në Republikën e Shqipërisë. Autoriteti i llogarive detare raporton pranë ERT-së çdo raport shtesë, modifikim ose fshirje në listën e mjeteve të lundrimit, për të cilat ai është duke kryer ose parashikon të kryejë shlyerjen e detyrimeve. Lista duhet të përmbajë vetëm mjetet e lundrimit të regjistruara në Republikën e Shqipërisë.

Deri më 1 shkurt të çdo viti, autoriteti i llogarive detare paraqet pranë ERT-së një raport vjetor, i cili do të përmbajë listën e mjeteve të lundrimit për të cilat ky autoritet ka kryer shlyerjen e detyrimeve deri më 31 dhjetor të një viti më parë. Lista duhet të përmbajë vetëm mjetet lundruese të regjistruara në Republikën e Shqipërisë.

3. Pagesat

Të gjitha llogaritë ndërkombëtare detare duhet të paguhen në kohë në përputhje me rregulloret në fuqi të ITU-së, Rregulloret Ndërkombëtare të Telekomunikacioneve (Melburn 1988), rekomandimet në fuqi të ITU-T dhe rregulla të tjera të nxjerra nga ERT-ja.

Çdo autoritet i llogarive detare duhet të pranojë faturat e ardhura nga administratat e huaja në SDR (njësi monetare që përcaktohet nga Fondi Monetar Ndërkombëtar) ose në franga ari. Franga e arit mund të konvertohet në SDR nëpërmjet një koeficienti të përcaktuar nga ITU. Po kështu, një llogari ekuivalente në dollar mund të paguhet bazuar në kursin e këmbimit për ditën e marrjes së faturës që publikohet nga Fondi Monetar Ndërkombëtar (FMN).

ERT-ja mund të ndërmarrë veprime të tilla si heqje të së drejtës për ushtrimin e aktivitetit si “autoritet i llogarive detare”, për arsytet e mëposhtme:

- a) dështimi për të filluar pagesat brenda gjashtë muajve nga marrja e licencës ose dështimi për të kryer pagesat brenda një periudhe gjashtë mujore të caktuar;

- b) paraqitja e dokumentacionit të rremë ose të falsifikuar;

- c) vonesa në shlyerjen e detyrimeve ndaj një ofruesi shërbimi;

- d) shkelje për të vepruar në përputhje me kërkesat dhe procedurat e përcaktuara në radio rregulloret e ITU-së dhe në rregulloret ndërkombëtare të telekomunikacioneve (ITR);

- e) shkelja e rregullores së ERT-së;

- f) falimentimi.

Përpara marrjes së masave të sipërpërmendura, ERT-ja do të paralajmërojë autoritetin e llogarive detare dhe do të japë një periudhë 30-ditore për një përgjigje me shkrim.

Kur autoritetit të llogarive detare i hiqet e drejta e ushtrimit të aktivitetit, ai është përgjegjës të njoftojë menjëherë të gjitha mjetet e lundrimit, të cilave ai u ofron shërbim.

Pronarët e anijeve të regjistruara në një autoritet të llogarive detare, i cili është subjekt i pezullimit ose heqjes së licencës, do të bëjnë marrëveshje kontraktuale me një tjetër autoritet të llogarive detare për të kryer pagesat e tyre.

Në rastin kur pronari i anijes nuk kryen ose vonon pagesat ndaj autoritetit të llogarive detare përkatëse merren këto masa administrative:

- a) Gjobë ose sanksione të tjera të autorizuar.
- b) Refuzim nga ana e stacioneve bregdetare vendase ose të huaja i ofrimit të shërbimit të korrespondencës publike. Ky veprim mund të ndërmerret me kërkesë të ERT-së ose në mënyrë të pavarur nga stacionet bregdetare.
- c) Veprime të mëtejshme për të mbuluar llogaritë e prapambetura duke përdorur ndonjë ose të gjitha procedurat e nevojshme për grumbullimin e debiteve.

4. Regjistrimi

Enti Rregullator i Telekomunikacioneve është përgjegjës për regjistrimin në ITU të autoriteteve të llogarive detare, përcaktuar me një kod identifikimi (AAIC).

ERT-ja gjithashtu mund të caktojë që një autoritet i llogarive detare, i regjistruar në një shtet tjetër, të jetë përgjegjës financiar për anijet e licencuara prej tij.

ERT-ja mban dhe njofton në ITU dy lista të autoriteteve të llogarive detare:

Lista A, detajon vetëm ato autoritete të llogarive detare (ALD) të autorizuar të kenë përgjegjësi financiare për anijet e licencuara nga ERT-ja, pavarësisht nëse ALD-ja është ose jo brenda territorit të Shqipërisë.

Lista B, në të kundërt, detajon të gjitha ALD-të, që janë vetëm brenda territorit të Shqipërisë, megjithëse mund të mos jenë të autorizuar financiarisht për anijet e licencuara nga ERT-ja.

Lista alfabetike e të gjitha autoriteteve të llogarive detare të njohura së bashku me AAIC-të e tyre, publikohet nga ITU-ja. ERT-ja është përgjegjëse për sigurimin e njoftimeve të menjëhershme në ITU të ndonjë shtese, ndryshimi ose fshirje të ndonjë ALF-je.

V. SISTEMI GLOBAL I FATKEQËSIVE DHE SIGURISË DETARE

Për të gjitha mjetet e lundrimit subjekt të Konventës SOLAS sistemi global GMDSS është një kërkesë e detyrueshme.

Subjekti i Konventës SOLAS janë të gjitha anijet e mallrave me peshë mbi 300 tonë, klasa të ndryshme të anijeve të pasagjerëve dhe të anijeve të peshkimit.

Këto mjete lundruese do të vazhdojnë të monitorojnë kanalin 16 deri në 1 shkurt 2005. Mbas kësaj date me të gjitha mjetet e lundrimit që janë subjekt i Konventës SOLAS dhe me stacionet bregdetare do të komunikohet vetëm me pajisjet radio DSC.

Kërkesat dhe përdorimet operacionale të sistemit GMDSS, i cili është i përcaktuar plotësisht në Konventën për shpëtimin në det (SOLAS) janë dhënë në nenin S30 dhe frekuencat që do të përdoren për transmetim në këtë sistem janë treguar në shtojcën S15 të rregulloreve radio të ITU-së.

GLOSAR

AAIC: Kodi i identifikimit të autoritetit të llogarive detare (Authority Accounting Identification Code).

DSC: Digital Selektive Calling. Një sistem sinkron zhvilluar nga Komiteti Konsultativ Radio Ndërkombëtar (CCIR), përdorur për krijimin e kontakteve automatike me një stacion ose grup stacionesh në kuptimin e transmetimit radio. Karakteristikat funksionale dhe teknike të këtij sistemi sqarohen në rekomandimin CCIR 493.

GMDSS: Sistemi global i fatkeqësisë dhe i shpëtimit në det (Global Maritime Distress and Safety System).

Koordinimi mbarë botëror i sistemit që siguron transferimin e shpejtë të mesazheve të emergjencës nga mjetet e lundrimit në rrezik në njësitë e autorizuar për koordinimin e ndihmës.

Sistemi përfshin pajisje standarde dhe procedura funksionale unike identifikuese për çdo stacion dhe integron përdorimin e brezave të frekuencave dhe sistemeve radio për të siguruar transferimin e mesazhit nga stacionet tokësore në stacionet e vendosura në bordet e anijeve.

IMO: Organizata Ndërkombëtare Detare (Internacional Maritime Organization).

ITU: Bashkimi Ndërkombëtar i Telekomunikacionit (International Telecommunication Union).

Kanale ndërkombëtare: Kanale të frekuencave të përcaktuara, në bazë të radio rregulloreve të

ITU-së dhe planit kombëtar të radiofrekuencave për shërbimin e lëvizshëm detar në rang ndërkombëtar.

Kanale kombëtare: kanale të frekuencave të përcaktuara, në bazë të planit kombëtar të radiofrekuencave, për shërbimin e lëvizshëm detar në rang kombëtar.

MMSI: Identiteti i shërbimit të lëvizshëm detar (Maritime Mobile Service Identity). Identifikimi i stacionit radio detar në rastin e përdorimit të pajisjeve radio DSC.

SDR: Special Drawing Right. Një njësi monetare që përcaktohet nga Fondi Monetar Ndërkombëtar. Llogaritet mbi bazën e shportës së raporteve të shkëmbimit të monedhave të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Gjermanisë, Britanisë së Madhe, Francës dhe Japonisë. Është një nga monedhat e përdorura për efekt të pagesave të llogarive ndërkombëtare në shërbimin e lëvizshëm detar dhe në shërbimin e lëvizshëm detar satelitor.

SOLAS: Konventa e shpëtimit të jetës në det.

Stacion anije: Një stacion i lëvizshëm në shërbimin e lëvizshëm detar, i vendosur në bordin e një mjeti lundrimi ose anijeje.

Stacion bregdetar: Një stacion tokësor në shërbimin e lëvizshëm detar.

Shërbimi i operimeve portual: Shërbimi i lëvizshëm detar në ose pranë një porti, përmes stacioneve bregdetare dhe stacioneve të anijeve ose përmes stacioneve të anijeve, në të cilin mesazhet kufizohen lidhur me operimet portuale, lëvizjen dhe shpëtimin e anijeve dhe në raste emergjente me shpëtimin e personave. Mesazhet e korrespondencës publike përjashtohen nga ky shërbim.

Shërbimi i lëvizjes së anijeve: Shërbimi i shpëtimit në shërbimin e lëvizshëm detar, përmes stacioneve bregdetare dhe stacioneve të anijeve ose përmes stacioneve të anijeve, në të cilin mesazhet kufizohen në komunikimet lidhur me lëvizjen e anijeve. Mesazhet e korrespondencës publike përjashtohen nga ky shërbim.

V E N D I M

Nr.371, datë 5.6.2003

PËR MIRATIMIN E LISTËS PARAPRAKE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME PUBLIKE, QË TRANSFEROHEN NË PRONËSI TË BASHKISË SË KUÇOVËS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, me propozimin e Ministrit të Pushtetit Vendor dhe të Decentralizimit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike shtetërore, që transferohen në pronësi të Bashkisë së Kuçovës, sipas tabelës që i bashkëlidhet këtij vendimi. Kjo listë paraprake, sipas kërkesave të këshillit bashkiak të Kuçovës, është pjesë e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, që janë brenda juridiksionit territorial dhe administrativ të Bashkisë së Kuçovës miratuar me vendimin nr.100, datë 20.2.2003 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore në Bashkinë e Kuçovës”.

2. Pronat me numër rendor inventari nga 370 në 373 të vazhdojnë të përdoren nga përdoruesit e sotëm në bazë të aktmarrëveshjeve ose të rregullimeve të tjera ligjore ndërmjet tyre dhe Bashkisë së Kuçovës.

3. Ngarkohet Ministria e Pushtetit Vendor dhe e Decentralizimit dhe Bashkia e Kuçovës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Lidhja 1

Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit	Fushat e përdorimit të pronës
1-8, 16-17	Prona për shërbime të ndryshme
9-10	Monumente historike e kulturore dhe buste me interes vendor
11-15	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve sociale
18-26	Prona që përdoren për strehim dhe mbrojtje civile
27-72	Infrastrukturë vendore dhe shërbime publike
73-94	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve ekonomike
95-96	Troje dhe hapësira publike
97-98	Rrugë vendore dhe rrjeti i ndriçimit publik
99	Varreza publike
370- 373	Zyra të partive politike, shoqatave ose zyra të tjera që ndodhen në ndërtesën e bashkisë
384-400	Prona që përdoren për realizimin e programeve arsimore
254,402-408	Prona që përdoren për realizimin e veprimtarive social- kulturore e sportive
409-419	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në shëndetin publik

V E N D I M
Nr.377, datë 12.6.2003

PËR MIRATIMIN E PROGRAMEVE TË RISTRUKTURIMIT, NË FUNKSION TË PRIVATIZIMIT TË INSIG-SHA

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 6 e 12 të ligjit nr.8306, datë 14.3.1998 “Për strategjinë e privatizimit të sektorëve me rëndësi të veçantë”, i ndryshuar dhe të nenit 10 të ligjit nr.8899, datë 22.5.2002 “Për përcaktimin e formës dhe të formulës së privatizimit të INSIG-sh.a.”, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Miratimin e programeve të ristrukturimit, që i bashkëlidhen këtij vendimi, në funksion të privatizimit të INSIG-sh.a., si më poshtë vijon:

- Ristrukturimi i burimeve njerëzore të INSIG- sh.a., në prag të privatizimit (faza e dytë).
- Zgjidhja e investimeve problematike në banesa, të INSIG-sh.a.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

PROGRAMI
PËR RISTRUKTURIMIN E BURIMEVE NJERËZORE TË INSIG -SHA, NË PRAG TË PRIVATIZIMIT (FAZA E DYTË)

1. Hyrje

Programi i ristrukturimit të burimeve njerëzore të shoqërisë anonime “Instituti i Sigurimeve,” i

miratuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr.61, datë 24.2.2000, ishte parashikuar të realizohej në dy faza:

1. Ristrukturimi tekniko-administrativ dhe ekonomiko-financiar nga degët deri në zyrat qëndrore.

2. Përgatitja e kushteve për privatizimin e kompanisë.

Faza e parë e programit të ristrukturimit dhe përgatitjes për privatizim e INSIG-sh.a., përfundoi që në vitin 2000. Në zbatim të vendimit të mësipërm, 12 degë të INSIG-sh.a. në rrethe, të cilat ishin joefektive u kthyen në agjenci sigurimesh dhe numri i punonjësve u reduktua ndjeshëm edhe në degët e tjera. Gjithashtu në kuadër të riorganizimit dhe ristrukturimit, si dhe për t'iu përgjigjur sa më mirë kushteve të reja të tregut të sigurimeve, pati ulje të numrit të punonjësve edhe në qendër. Për të zgjidhur anën sociale të këtij problemi, punonjësve që u larguan për shkak të ristrukturimit, iu ofruan dy alternativa:

- Një kontratë agjencie për të shitur produktet e INSIG-sh.a., duke iu ofruar për një periudhë gjashtëmujore një shërbim fiks në masën 50 për qind të pagës.

- Punonjësve, që nuk e pranuan këtë alternativë, iu dha paga e plotë për një periudhë 1- vjeçare dhe 50 për qind e pagës për 6 muajt e tjerë të vitit pasardhës.

Ky reduktim ka qenë i domosdoshëm dhe ka ndikuar pozitivisht. Aktualisht INSIG-sh.a., në zbatim të fazës së dytë të ristrukturimit të burimeve njerëzore të kompanisë në funksion të privatizimit të kompanisë, duhet të bëjë një ulje të mëtejshme të numrit të personelit me objektiv:

1. uljen e shpenzimeve ekonomiko-administrative;

2. rritjen e efektivitetit në punë, përmes optimizimit të organigramës funksionale të kompanisë;

3. motivimin e punonjësve që do të mbeten, në funksion të rritjes së profesionalizmit, përshtatjes me funksionet komerciale dhe pengimit të lëvizjes së specialistëve të kualifikuar.

2. ANALIZA E SITUATËS, PROGRAMI I RISTRUKTURIMIT.

Aktualisht në INSIG-sh.a., (Shqipëri) punojnë 362 punonjës dhe nga analiza e gjendjes rezultojnë që ky numër do të duhej të reduktohej me 40 për qind, pra do të duhej të largoheshin 145 punonjës.

A. Kriteret për përzgjedhjen e personelit

Për përzgjedhjen e personelit, që do të mbeten në INSIG-sh.a., do të përdoren kriteret e mëposhtme:

1. Niveli arsimor: përparësi do të kenë punonjësit me arsim të lartë të profileve ekonomike, juridike dhe inxhinierike, po kështu do të konsiderohet përfundimi në këto degë i studimeve universitare jashtë vendit.

2. Vjetërsia në sigurime: përparësi do të kenë punonjësit që kanë eksperiencë në sigurime mbi tre vjet.

3. Korrektësia dhe përkushtimi në punë, përparësi do të kenë punonjësit:

- që nuk kanë marrë masa disiplinore, masa nga Kontrolli i Lartë i Shtetit, nga kontrolli i brendshëm dhe që janë vlerësuar pozitivisht nga drejtuesit e strukturave përkatëse të INSIG - sh.a.;

- që nuk kanë detyrime të pashlyera kundrejt INSIG-sh.a. (veçanërisht të lidhura me banesat);

- që nuk kanë pasur dhe nuk kanë konflikte gjyqësore ose konflikte të tjera me INSIG- sh.a.

4. Gjuha e huaj dhe kompjuteri: përparësi do të kenë punonjësit që kanë të mbrojtur një gjuhë të huaj dhe që kanë njohuri në programet bazë të kompjuterit.

5. Kualifikimet: përparësi do të kenë punonjësit që janë kualifikuar në kurse të ndryshme, brenda ose jashtë vendit, sidomos në fushën e sigurimeve.

6. Realizimi i detyrave (sidomos për degët e INSIG-sh.a.): përparësi do të kenë punonjësit që kanë kontribuar më shumë në realizimin e të ardhurave nga primet.

B. Trajtimi i punonjësve që do të shkurohen

Punonjësit, që do të shkurohen si rezultat i procesit të ristrukturimit të INSIG-sh.a., përfitojnë shpërblim të menjëhershëm deri në 9 paga mujore, të diferencuar si më poshtë:

a) Punonjësit që janë emëruar në detyrë pas datës 31.12.2002 nuk do ta përfitojnë shpërblimin e mësipërm.

b) Punonjësit që janë emëruar në detyrë gjatë periudhës 1.7.1998 deri 31.12.2002 përfitojnë 6

paga mujore.

c) Punonjësit që janë emëruar në detyrë para datës 1.7.1998 përfitojnë 9 paga mujore.

Shpërblimin e mësipërm nuk duhet ta përfitojnë:

a) Punonjësit që largohen nga puna si rezultat i dhënies së masave disiplinore.

b) Punonjësit që largohen nga puna (në periudhën e ristrukturimit) pa pëlqimin e punëdhënësit.

c) Punonjësit që janë ripunësuar në INSIG-sh.a., pasi janë larguar nga ristrukturimi i vitit 2000.

Të gjithë punonjësit, që mbushin moshën e pensionit brenda 9 muajve nga data e hyrjes në fuqi të vendimit të qeverisë, do të përfitojnë shpërblim, në raport me kohën që ju mbetet për mbushjen e moshës së pensionit.

C. Afati i zbatimit të programit:

Brenda 15 gushtit të vitit 2003 numri i punonjësve të INSIG-sh.a., në Shqipëri, të jetë jo më shumë se 220 punonjës.

Për realizimin e ndryshimeve të mësipërme do të zbatohen disa kritere, në mënyrë që ky proces të realizojë objektivin dhe të jetë sa më transparent për të shmangur maksimalisht pasojat sociale.

D. Zbatimi i programit

INSIG-sh.a. duhet të marrë të gjitha masat që:

Ndërprerja e marrëdhënieve financiare me punonjësit që do të preken nga ristrukturimi do të bëhet pasi palët të kenë shlyer të gjitha detyrimet që mund të kenë ndaj njëra-tjetrës.

Në rast se ndërmjet punonjësve të shkurtuar do të ketë nga ata që kanë “kontratë shitjeje” apartamenti me kushte lehtësuese, kushtet nuk do të ndryshojnë kur shkurtimi bëhet për shkak të ristrukturimit.

PROGRAM PËR ZGJIDHJEN E INVESTIMEVE PROBLEMATIKE NË BANESA TË INSIG-SHA

Hyrje

Me anë të këtij programi synohet të përcaktohen hapat për zgjidhjen përfundimtare të investimeve problematike në banesa të INSIG-sh.a.

Në funksion të privatizimit, jo vetëm investimet me probleme, por i gjithë aktiviteti i sigurues dhe financiar i kompanisë është analizuar me një kujdes të veçantë për të gjetur përgjegjësitë dhe analizuar shkaqet e problemeve dhe ajo që është më e rëndësishmja, të përcaktohen rrugëzgjdhjet më efektive dhe me kosto sa më të ulët.

Duke mbajtur në konsideratë faktin se INSIG-sh.a. është një kompani sigurimi, ku aktiviteti bazë është ai i sigurues, edhe sikur portofoli i investimeve në banesa të rezultonte pa problemet e njohura, përsëri institucionet financiare ndërkombëtare dhe blerësit potencialë nuk do të pranonin ose do të rishikonin statusin e këtij portofoli për këto arsye:

- Kompanitë e sigurimit nuk i menaxhojnë vetë investimet në pasuri të patundshme.

- Meqenëse investimet në banesa janë përgjithësisht afatgjata (15-30 vjet), IFC-ja dhe BERZH-i nuk e kanë në politikën e tyre të investojnë në periudha kaq të gjata. Ato projektojnë rezultatet e tyre financiare në periudha më të shkurtëra kohore.

- Investimet në banesa, në rastin e INSIG-sh.a., nuk janë projektuar si investime me të njëjtin rend fitimprurjeje, si bankat ose shoqëritë e ndërtimit. Norma e interesit të tyre është disa herë më e ulët, se ato që japin bankat e nivelit të dytë. Në këto kushte IFC-ja dhe BERZH-i nuk do të preferonin kursesi të ngatërronin politikat tërësisht komerciale me bonuset.

Në kontekstin e problemeve të mbartura historike shfaqen objektivisht elementet sa vijon:

- Investimet në ndërtime janë dizenuar duke pasur parasysh kushtet në vitet 1993-1994, duke parashikuar një shpërndarje prej 80 për qind të totalit në drejtimin komercial dhe vetëm 20 për qind për plotësimin e nevojave për strehim të punonjësve.

- Ndërhyrjet politike në administrimin e këtyre investimeve bënë që të vërtetohen deviacione nga shpërndarja e planifikuar e investimeve të realizuara, duke mënjeluar drejtimin komercial të tyre.

- Ngjarjet e vitit 1997 shënojnë fillimin e regresit total në administrimin e portofolit të investimeve për shkak të:

i) problemeve të drejtimit të INSIG-ut, si rezultat edhe i zëvendësimeve të shpeshta, sidomos në periudhën 1997-1999;

ii) marrëdhëniet me sipërmarrësin nuk kanë qenë konsekuente.

Angazhimi për zgjidhje konkrete i investimeve problematike të INSIG-ut trajtohet në funksion të privatizimit të kompanisë, për të cilat Këshilli Mbikëqyrës i INSIG-sh.a. ka evidentuar, grupuar dhe miratuar zgjidhjen e propozuar.

Arsyetimi për zgjidhjen e propozuar mbështetet:

Kontrata tip që INSIG-sh.a. ka me kreditorët përbëhet nga këto elemente:

b) interesi vjetor 2 për qind;

c) afati i livrimit 10, 20 apo 30 vjet;

d) kursi i këmbimit 1 USD = 120 lekë.

Nëse do t'i referohemi tregjeve të brendshme dhe atyre ndërkombëtare të investimeve financiare, sidomos atyre të bonove të thesarit të Qeverisë shqiptare apo të vendeve të tjera, ku afatet e investimeve janë disavjeçare, si dhe interesa vjetore në shifra të vlerësuar 5-7 për qind, do të ishte më mirë që sot klientëve të INSIG-ut t'u propozohej një mënyrë tjetër e shlyerjes së kredisë dhe konkretisht në formën e pagesës së menjëhershme, vlera e së cilës përcaktohet në funksion të kushteve të reja të investimit që mendohet të bëhet nga ana e INSIG-sh.a.

Në llogaritjet e mëposhtme interesi teknik mesatar do të jetë 6 për qind për secilin grup (ky propozim është bërë edhe nga kompania audituese "Deloitte & Touche" dhe present value llogaritet për secilin grup sipas karakteristikave të tij.

PROGRAM PËR ZGJIDHJEN E APARTAMENTEVE TË KONTRAKTUARA

Apartamentet e kontraktuara përbëhen si më poshtë:

Grupi i parë:

Në këtë grup bëjnë pjesë 38 apartamente të kontraktuara nga të tretët (31 apartamente + 7 garsoniere) me afat shlyerjeje 10 vjet.

Grupi i dytë:

Në këtë grup bëjnë pjesë 133 apartamente të kontraktuara nga punonjës ose ishpunonjës të INSIG-ut me afat shlyerjeje 20 ose 30 vjet.

Pjesa e mbetur e këtij portofoli (grupi i parë + grupi i dytë) do t'i kalojë Agjencisë së Trajtimit të Kredive, e cila nga ana e saj mund të negociojë direkt edhe me bankat e nivelit të dytë për shitjen e këtij portofoli.

PROGRAM PËR ZGJIDHJEN E APARTAMENTEVE TË PAKONTRAKTUARA

Në këtë grup bëjnë pjesë një kategori ndërtesash të zëna forcërisht e konkretisht 64 apartamente (ALMAK) të pakontraktuara, vlera e të cilave është 2.050.478 USD.

Propozimi i Këshillit Mbikëqyrës të INSIG-sh.a. për këtë kategori apartamentesh, të cilat shfrytëzohen në mënyrë të jashtëligjshme nga të tretë, ka qenë që t'u ofrohen këtyre personave me pagesë të menjëhershme në masën 100 për qind të vlerës së kostos.

Por mbështetur edhe në eksperiencën e tjera të ngjashme, si dhe për të mos privilegjuar një kategori njerëzish që okupojnë forcërisht pronën shtetërore, për këtë grup propozohen dy zgjidhje me këtë renditje prioritare:

1) kalimi i këtij portofoli tek Enti Kombëtar i Banesave;

2) kalimi i këtij portofoli tek Agjencia e Trajtimit të Kredive.

Në zgjidhjen e këtij problemi do të ndihmojnë edhe forcat e rendit, përkundrejt kushteve që do të vendosen me to.

V E N D I M
Nr.378, datë 12.6.2003

PËR PAGESËN NGA FONDET E INSIG-SHA TË SHPENZIMEVE QË DO TË BËHEN NGA IFC-JA DHE BERZH-I NË FUNKSION TË PRIVATIZIMIT TË INSIG-SHA

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 6 e 12 të ligjit nr.8306, datë 14.3.1998 “Për strategjinë e privatizimit të sektorëve me rëndësi të veçantë” dhe të ligjit nr.8899, datë 22.5.2002 “Për përcaktimin e formës dhe të formulës së privatizimit të INSIG-sh.a.” me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Miratimin e pagesës prej 130 000 dollarësh nga fondet e INSIG-sh.a., të shpenzimeve që do të bëhen nga IFC-ja dhe BERZH-i në funksion të fazës së parë të privatizimit të kësaj shoqërie.
 2. Ngarkohet Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

V E N D I M
Nr.381, datë 12.6.2003

PËR SHPËRBLIMIN E ANËTARËVE TË KËSHILLIT TË LARTË TË DREJTËSISË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3 të nenit 6 të ligjit nr.8811, datë 17.5.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë”, me propozimin e Ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Anëtarët e Këshillit të Lartë të Drejtësisë përfitojnë një shpërblim në masën 10 000 (dhjetë mijë) lekë, për çdo mbledhje për ushtrimin e funksionit të tyre.
 2. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të fillojnë në datën 8.5.2002 dhe të përballohen nga fondet buxhetore të vitit 2003, miratuar për Këshillin e Lartë të Drejtësisë.
 3. Ngarkohet Këshilli i Lartë i Drejtësisë dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

V E N D I M
Nr.391, datë 12.6.2003

PËR FILLIMIN E PROCEDURËS SË DHËNIES ME KONCESION TË FORMËS “ROT”, TË HIDROCENTRALIT TË GJANÇIT NË KORÇË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 3, 5 e 7 të ligjit nr.7973, datë 26.7.1995 “Për koncesionet dhe pjesëmarrjen e sektorit privat në shërbimet publike dhe në infrastrukturë”, i ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Industrisë dhe të Energjetikës dhe të Ministrit të Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Fillimin e procedurës së dhënies me koncesion të hidrocentralit të Gjançit në rrethin e Korçës, shoqërisë “Spahiu” sh.p.k., sipas propozimit të pakërkuar.
 2. Forma e koncesionit të jetë “ROT” (rehabilitim, operim, transferim).
 3. Ministria e Industrisë dhe e Energjetikës, Ministria e Ekonomisë dhe Ministria e Bujqësisë dhe e Ushqimit të jenë organi shtetëror i autorizuar (OSHA) për negocimin dhe nënshkrimin e kontratës koncesionare.
 4. Ngarkohen Ministria e Industrisë dhe e Energjetikës, Ministria e Ekonomisë dhe Ministria e Bujqësisë dhe e Ushqimit për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

V E N D I M

Nr.392, datë 12.6.2003

PËR MIRATIMIN E STATUTIT TË AGJENCISË SË NXITJES SË EKSPORTEVE (ANE)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 1 pika 2 e 9 të ligjit nr.9023, datë 6.3.2003 “Për krijimin e Agjencisë së Nxitjes së Eksporteve”, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Miratimin e statutit të Agjencisë së Nxitjes së Eksporteve (ANE), që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

STATUTI

I AGJENCISË SË NXITJES SË EKSPORTEVE (ANE)

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Vlera ligjore e statutit

Statuti është dokumenti bazë që rregullon veprimtarinë e kësaj Agjencie brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, krijimi i së cilës është parashikuar nga neni 1 pika 2 të ligjit nr.9023, datë 6.3.2003 “Për krijimin e Agjencisë së Nxitjes së Eksporteve”.

Neni 2

Statusi juridik i Agjencisë

Agjencia e Nxitjes së Eksporteve është person juridik dhe nuk ushtron veprimtari fitimprurëse. Nëse ndonjë veprimtari mund të gjenerojë të ardhura, këto duhet të kontabilizohen në zërat përkatës të fondeve të Agjencisë dhe do të përdoren vetëm për qëllimin për të cilin është krijuar Agjencia.

Neni 3
Emërtimi i shkurtuar

Emërtimi i shkurtuar i Agjencisë është ANE. Selia e Agjencisë ndodhet në Tiranë, në adresën: Bulevardi “Zhan d’Ark”, pallatet e Lanës.

Neni 4
Stema dhe vula

Stema e Agjencisë shpreh thelbin e aktivitetit të saj, që është nxitje e eksporteve dhe duhet të figurojë në të gjitha materialet prezantuese dhe shkresat zyrtare të Agjencisë.

Përmbajtja e vulës së Agjencisë është: Republika e Shqipërisë, Agjencia e Nxitjes së Eksporteve (ANE).

OBJEKTI I VEPRIMTARISË SË AGJENCISË

Neni 5
Ligjshmëria e veprimtarisë

ANE e ushtron veprimtarinë në përputhje me dispozitat e Kodit Civil, ligjit “Për krijimin e Agjencisë së Nxitjes së Eksporteve (ANE)” dhe legjislacionit në fuqi.

Neni 6
Objekti

Agjencia do të ketë objekt të veprimtarisë:

- Zhvillimin e informacionit tregtar duke siguruar mbledhjen, përpunimin dhe shpërndarjen e të dhënave që kanë të bëjnë me investimet, tregun dhe zhvillimin e biznesit brenda dhe jashtë vendit, në mënyrë që të zhvillojë kulturën e ndërmarrjeve private në të gjithë sektorët ekonomikë në vend dhe të sigurojë informacionin e duhur mbi biznesin.

- Mbajtjen e lidhjeve me të gjitha ministritë, agjencitë publike, institucionet financiare, dhomat e tregtisë, shoqatat e biznesit dhe të investitorëve dhe organizata të tjera të interesuara, për të koordinuar veprimtaritë që u shërbejnë investitorëve.

- Inkurajimin e prodhimit për eksport dhe shfrytëzimin e oportuniteteve në tregjet jashtë vendit, duke survejuar mundësitë e tregut dhe zhvillimin e ekspertizës së burimeve financiare.

- Puna për rritjen e aftësisë konkurruese të produkteve shqiptare në tregjet e huaja duke nxitur cilësinë e menaxhimit të produkteve për eksport në mënyrë që të rrisë kërkesën potenciale për to, veçanërisht nëpërmjet njohjes së standardeve dhe specifikimeve për cilësinë, ambalazhimin, paraqitjes së produkteve të eksportuara dhe njohjes së teknologjive moderne të paketimit të këtyre produkteve.

- Propozon masa për mbështetjen dhe krijimin e lehtësirave financiare të nevojshme për eksportuesit.

- Planifikimin dhe marrjen përsipër të veprimtarive promovuese në Shqipëri dhe jashtë saj për të projektuar një imazh favorizues për Shqipërinë si një burim atraktiv të: mallrave, shërbimeve, lëndëve të para dhe burimeve njerëzore.

- Të bëjë kërkime në lidhje me aktivitetet e tjera të saj, duke përfshirë studime fizibiliteti, kërkime mbi tregun dhe survejime të opinionit publik, konsultime me praktikant tregtare dhe menaxhuese.

BURIMET E FINANCIMIT

Neni 7
Burimet bazë të financimit

Në përputhje me nenin 8 të ligjit nr.9023, datë 6.3.2003 “Për krijimin e Agjencisë së Nxitjes

së Eksporteve” si burim financimi për Agjencinë shërben Buxheti i Shtetit. Agjencia mund të sigurojë fonde shtesë edhe nga donatorë të ndryshëm.

Neni 8

Përdorimi i fondeve

Agjencia gëzon të drejtën e depozitimit dhe përdorimit të mjeteve të saj financiare në bazë të vendimeve të Këshillit Mbikëqyrës.

Agjencia nuk mund të kryejë asnjë lloj veprimtarie tjetër, jashtë objektivave dhe programit të përcaktuar në statutin e saj.

Fondet financiare të saj nuk mund të përdoren në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe as të tërthortë për qëllime të tjera.

Financimi që Agjencia merr nga burime të ndryshme përdoren vetëm për kryerjen e veprimtarive sipas objektit të saj.

Neni 9

Qëndrimi ndaj donacioneve

Donacionet pranohen ose kundërshtohen me vendim të Këshillit Mbikëqyrës të Agjencisë. Vendimi i Këshillit Mbikëqyrës të Agjencisë përmban edhe arsyet e refuzimit.

Donatorët e huaj ose vendas, të cilët kontribuojnë me fonde financiare, me një vlerë që përbën më shumë se 50 për qind të fondeve vjetore të buxhetit të shtetit për Agjencinë, kanë të drejtë të caktojnë një këshilltar pranë Drejtorit ekzekutiv të Agjencisë. Drejtori ekzekutiv duhet të konsultohet me këshilltarin për të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me përdorimin e fondeve të dhëna nga donatori.

STRUKTURA ORGANIZATIVE E AGJENCISË

Neni 10

Organet drejtuese

Organet e Agjencisë janë (1) Këshilli Mbikëqyrës dhe (2) Drejtori Ekzekutiv.

KËSHILLI MBIKËQYRËS

Neni 11

Përbërja

Përbërja e Këshillit Mbikëqyrës është si më poshtë:

- Zëvendësministri i Ekonomisë Kryetar
- Zëvendësministri i Bujqësisë dhe i Ushqimit Anëtar
- Drejtori i Agjencisë së Nxitjes së Investimeve të Huaja Anëtar
- Përfaqësues i Këshillit të Agrobiznesit Shqiptar Anëtar
- Përfaqësues i Shoqatës së Eksportuesve Shqiptar Anëtar

Anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës që përfaqësojnë komunitetin e biznesit emërohen nga Ministri i Ekonomisë me propozim të shoqatave të biznesit për një periudhë 2-vjeçare me sistem rotacioni. Përfaqësuesit e komunitetit të biznesit duhet të plotësojnë kriteret e përcaktuara në udhëzimin e Ministrit të Ekonomisë.

Kryetari i Këshillit Mbikëqyrës informon Ministrin e Ekonomisë për probleme të rëndësishme lidhur me nxitjen e eksporteve.

Neni 12

Mandati i anëtarit të Këshillit Mbikëqyrës

Mandati i anëtarit të Këshillit Mbikëqyrës përfundon me:

- a) mbarimin e afatit të përcaktuar në nenin 11 të statutit të Agjencisë, si dhe në rastet kur:

- b) jep dorëheqjen;
 - c) me propozim të Ministrit të Ekonomisë, Këshilli Mbikëqyrës shkarkon nga detyra për veprime ose mosveprime që dëmtojnë rëndë interesat e Agjencisë;
 - d) mungon pa arsye në 4 mbledhje dhe me arsye në 6 mbledhje të një viti;
 - e) kur bëhet i paaftë fizikisht ose mendërisht.
- Kërkesa për dorëheqje i bëhet me shkrim Ministrit të Ekonomisë, i cili duhet ta miratojë atë brenda 5 (pesë) ditëve.

Neni 13

Kompetencat e Këshillit Mbikëqyrës

Këshilli Mbikëqyrës ka këto kompetenca:

- Harton projektin e parë të statutit të Agjencisë dhe i propozon ndryshimet e tij në të ardhmen, Këshillit të Ministrave.
- Miraton programin e veprimtarisë së Agjencisë për vitin financiar, i cili paraqitet nga Drejtori ekzekutiv i Agjencisë.
- Propozon në Këshillin e Ministrave miratimin e buxhetit dhe propozon për miratim tek Kryeministri nëpërmjet Ministrit të Ekonomisë strukturën organizative të Agjencisë sipas rregullave dhe afateve që përcaktohen në ligjin organik të Buxhetit të Shtetit dhe akteve të tjera nënligjore.
- Miraton rregulloren e brendshme për funksionimin e Agjencisë.
- Emëron dhe liron nga detyra Drejtorin ekzekutiv.
- Miraton bilancin e veprimtarisë ekonomiko-financiare në përputhje me legjislacionin në fuqi.
- Mbikëqyr në vazhdimësi përmbushjen e detyrave nga Agjencia.

Neni 14

Mbledhja e Këshillit Mbikëqyrës

Këshilli Mbikëqyrës mbledhet në mënyrë periodike, jo më pak se 4 herë në vit. Atë e thërret Kryetari i Këshillit Mbikëqyrës. Anëtarët lajmërohen me shkrim nga Drejtori ekzekutiv, 15 ditë para zhvillimit të mbledhjes. Në njoftimin e mbledhjes jepet data, ora, vendi i zhvillimit të mbledhjes, si dhe rendi i ditës. Kur ka nevojë, njoftimit i bashkëlidhen edhe projektvendimet që parashikohen të merren në mbledhje.

Në raste të veçanta mbledhja e tij thirret nga Drejtori ekzekutiv ose nga të paktën tre anëtarë të Këshillit Mbikëqyrës bashkërisht.

Mbledhja drejtohet nga Kryetari i Këshillit Mbikëqyrës dhe në mungesë të tij nga anëtari më i moshuar që merr pjesë në mbledhje.

Neni 15

Vlefshmëria e mbledhjeve

Këshilli Mbikëqyrës nuk mund të marrë vendime të vlefshme pa qenë të pranishëm të paktën një anëtar më shumë se gjysma e numrit të anëtarëve. Kur ky numër nuk arrihet mbledhja shtyhet dhe mbahet brenda 24 orëve.

Vendimet merren me shumicë të thjeshtë votash të anëtarëve të pranishëm. Votimi është i hapur, përveç rasteve të veçanta të parashikuara në ligj. Votimi mund të kryhet edhe me anë shkëmbimi të dokumentacionit të shkruar sipas rregullave të konsultimit me shkrim. Në rast rezultati të barabartë votash, vota e kryetarit është përcaktuese.

Neni 16

Pjesëmarrja në mbledhje e personave të tjerë

Në mbledhjet e Këshillit Mbikëqyrës kryetari fton këshilltarë ose/dhe ekspertë të jashtëm, kur këtë e kërkojnë rrethanat.

Drejtori ekzekutiv, këshilltarët dhe ekspertët e ftuar marrin pjesë në mbledhje pa të drejtë vote.

Neni 17

Konflikti i interesave

Anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës, detyrohen të deklarojnë pozicionin e tyre në Këshillin Mbikëqyrës kur çështjet e rendit të ditës dhe vendimet e Këshillit Mbikëqyrës lidhen direkt me interesat e biznesit të tyre. Në këto raste, ata nuk marrin pjesë në diskutime dhe as në votimin e vendimeve që merren për çështjet në fjalë.

Neni 18

Shpërblimi

Anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës gëzojnë të drejtën e shpërblimit për pjesëmarrjen në mbledhjet e Këshillit Mbikëqyrës, si dhe të rimbursimit të shpenzimeve për shërbime, udhëtime e dieta që lidhen me veprimtarinë e tyre për zbatimin e programit të Agjencisë.

Masat e shpërblimit të anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës të jenë:

Kundrejt pagesës mujore të Drejtorit ekzekutiv të Agjencisë: Për Kryetarin e Këshillit Mbikëqyrës 20% dhe anëtarët 10%.

DREJTORI EKZEKUTIV I AGJENCISË

Neni 19

Mandati i Drejtorit ekzekutiv

Drejtori ekzekutiv emërohet nga Këshilli Mbikëqyrës në mbledhjen e parë të Këshillit Mbikëqyrës për një afat mbi trevjeçar, me të drejtë zgjatjeje të këtij afati edhe për tre vjet të tjerë. Përzgjedhja e tij bëhet me konkurrim, që njoftohet publikisht në organet e shtypit, nga të paktën tre konkurrues.

Neni 20

Tagrat e përfaqësimit

Agjencia në marrëdhënie me të tretët përfaqësohet nga Drejtori ekzekutiv dhe në mungesë të tij, nga një punonjës i emëruar nga Drejtori ekzekutiv për një mandat trevjeçar ose me autorizim të Këshillit Mbikëqyrës.

Neni 21

Kompetencat

Drejtori ekzekutiv ka këto të drejta dhe detyra:

- Drejton dhe administron të gjithë veprimtarinë e Agjencisë dhe përgjigjet para Këshillit Mbikëqyrës.
- Harton rregulloren e brendshme të veprimtarisë së Agjencisë dhe ia paraqet për miratim Këshillit Mbikëqyrës.
- Bashkërendon punën për hartimin e projekt-buxhetit sipas rregullave dhe afateve që përcakton ligji organik i Buxhetit të Shtetit.
- Para fillimit të çdo veprimtarie, në funksion të përmbushjes së programit të punës, i paraqet Këshillit Mbikëqyrës buxhetin dhe programin për realizimin e tij.
- Harton dhe i paraqet për miratim Këshillit bilancin e Agjencisë.
- Përgjigjet për shpenzimet e bëra nga buxheti i Agjencisë në përputhje me objektivat, qëllimin e funksionimit të Agjencisë.

- Raporton të paktën 4 herë në vit para Këshillit Mbikëqyrës për veprimtarinë e Agjencisë.
- Harton dhe zbaton procedurat e punësimit të personelit, duke përdorur metodën e konkurrimit të shpallur publikisht për çdo vend pune.
- Bashkërendon punën me Këshillin Mbikëqyrës, për të zhvilluar dhe administruar me sukses strategjinë e qeverisë për nxitjen e investimeve.
- Përgjigjet për të gjitha veprimtaritë e Agjencisë që i shërbejnë përmirësimit të imazhit të Shqipërisë.
- Bashkëpunon me donatorë vendas dhe të huaj për sigurimin e fondeve të Agjencisë.
- Krijon, zhvillon dhe ruan lidhje të vazhdueshme institucionale me përfaqësues të organizatave të biznesit dhe institucioneve publike.
- Garanton cilësinë e materialeve informuese dhe promovuese të bëra nga Agjencia dhe shpërndarjen e tyre në kohë të institucioneve publike e private të interesuara.

Neni 22

Mbarimi i mandatit

Drejtori ekzekutiv lirohet nga detyra në rastet kur:

- a) mbaron mandati i emërimit dhe ai nuk rrimërohet;
- b) mbush moshën e pensionit;
- c) emërohet në një detyrë tjetër, të papajtueshme me atë të Drejtorit ekzekutiv.

Drejtori ekzekutiv lirohet nga detyra edhe para mbarimit të mandatit kur:

- a) konstatohet se nga drejtimi i tij i dobët Agjencia mbingarkohet me borxhe;
- b) shpallet fajtor me vendim të formës së prerë të gjykatës për veprat penale;
- c) vepron në kundërshtim me programin dhe objektivat e miratuara nga Këshilli Mbikëqyrës;
- d) konstatohet mungesë rezultatesh konkrete ose mospëmbushje objektivash;
- e) kur bëhet i paaftë fizikisht ose mendërisht.

MARRËDHËNIET E PUNËS

Neni 23

Niveli i pagave të Agjencisë

Niveli i pagave të Agjencisë përcaktohet e miratohet me vendim të Këshillit Mbikëqyrës, sipas akteve nënligjore të Ministrave për caktimin e pagave të punës për punonjësit e administratës shtetërore.

Neni 24

Rregullat e punësimit

Kriteret e marrjes në punë të personelit të Agjencisë, si dhe përshkrimi i vendeve të punës, përcaktohen nga Këshilli Mbikëqyrës dhe lidhja e kontratave të punës bëhet nga Drejtori ekzekutiv.

Neni 25

Viti financiar

Viti financiar i Agjencisë fillon më 1 janar dhe mbaron më 31 dhjetor. Për çdo vit financiar përpilohet bilanci ekonomik-financiar, i cili vlerësohet konform dispozitave ligjore në fuqi. Brenda datës 30 prill të çdo viti, Drejtori ekzekutiv i paraqet Këshillit Mbikëqyrës bilancin e vitit financiar paraardhës për shqyrtim dhe miratim.

Neni 26

Kontrolli

Për ushtrimin e kontrollit të veprimtarisë ekonomik-financiare të Agjencisë, Këshilli Mbikëqyrës cakton ekspertë ose ekspertë kontabël të autorizuar sipas ligjeve në fuqi.

DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 27

Përparësia e ligjit

Çështje specifike të veprimtarisë së Agjencisë, të cilat nuk parashikohen në këtë statut do të rregullohen në rregulloren e brendshme të Agjencisë.

Në përputhje me nenet 1 dhe 9 të ligjit nr.9023, datë 6.3.2003 “Për krijimin e Agjencisë së Nxitjes së Eksporteve” çdo ndryshim në statut miratohet nga Këshilli i Ministrave.

V E N D I M Nr.393, datë 12.6.2003

PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR.151, DATË 25.4.2002 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR STATUSIN “DËSHMOR I ATDHEUT””

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 4, 13 dhe 20 të ligjit nr.8607, datë 27.4.2000 “Për statusin “Dëshmor i Atdheut”” dhe të neneve 124 e 128 të ligjit nr.8485, datë 12.5.1999 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Në vendimin nr.151, datë 25.4.2002 të Këshillit të Ministrave, të bëhet shtesa si më poshtë vijon:

Në fund të shkronjës “a” të pikës 5, të shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:

“Kur familjari i autorizuar sipas listës dhe vendimit të Komisionit Qendror të Statusit “Dëshmor i Atdheut”, për tërheqjen e shpërblimit vdes, kjo e drejtë i kalon njërit nga pjesëtarët e trungut familjar të përcaktuar sipas ligjit “Për statusin “Dëshmor i Atdheut””, i cili paraqet në Institutin e Sigurimeve Shoqërore certifikatën e trungut familjar dhe prokurën e lëshuar nga përfituesit e tjerë.”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

V E N D I M Nr.394, datë 12.6.2003

PËR KALIMIN NË ADMINISTRIM TË BASHKISË SË QYTETIT TË KORÇËS TË ISH- SHTËPISË SË USHTARAKËVE NË KËTË QYTET

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të shkronjës “c” të nenit 15 të ligjit nr.8743, datë 22.2.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit” dhe të neneve 7 e 13 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Bashkisë së qytetit të Korçës t’i kalojë në administrim ish-shtëpia e ushtarakëve në këtë qytet për ta përdorur si qendër kulturore.
2. Ngarkohet Ministria e Mbrojtjes të bëjë dorëzimin e kësaj prone të paluajtshme.
3. Bashkisë së qytetit të Korçës i ndalohet ndryshimi i destinacionit të përcaktuar në pikën 1 të

këtij vendimi, tjetërsimi ose dhënia në përdorim të të tretët.

4. Ngarkohet bashkia e qytetit të Korçës të përballojë shpenzimet për mirëmbajtjen e pronës së dhënë në administrim.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI

Fatos Nano

U D H Ë Z I M
Nr.4, datë 11.6.2003

MBI PRIORITETET E TRAJTIMIT TË FAMILJEVE QË KANË HUMBUR BANESAT NGA RËNIA E SKEMAVE PIRAMIDALE

Mbështetur në nenin 102 të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë, vendimit të Këshillit të Ministrave nr.585, datë 11.12.1997 “Për evidentimin e familjeve që kanë humbur banesat nga rënia e skemave piramidale” dhe në zbatim të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.321, datë 5.7.1999 “Për miratimin e shpërndarjes së fondeve sipas rretheve, procedurat e miratimit të familjeve që përfitojnë dhe kushtet e dhënies së kredisë, në kuadrin e kredisë greke për strehimin”,

U D H Ë Z O J:

1. Trajtohen me përparësi familjet e evidentuara deri më datë 30.8.1999 sipas pikës 5 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.321, datë 5.7.1999, të cilët banojnë me qira dhe plotësojnë kriteret e mëposhtme:

- Banojnë në ambiente që nuk janë fond banese ose në banesa me kushte të vështira higjieno-sanitare.

- Kanë të ardhura të pamjaftueshme për të përballuar qiranë e banesës.

- Kanë në përbërjen e tyre një të sëmurë me raport të përhershëm mjekësor.

- Janë familje njëprindërore që kanë në ngarkim fëmijë.

2. Organet e qeverisjes vendore në bashkëpunim me Entin Kombëtar të Banesave, të rihartojnë listat me rastet më emergjente sipas pikës 1 të këtij udhëzimi.

3. Dokumentacioni që duhet të dorëzojë familja pranë organeve të qeverisjes vendore është si më poshtë:

- kontratën e qirasë dhe planimetrinë e banesës;

- certifikatën e gjendjes familjare;

- deklaratë mbi të ardhurat mujore;

- raport mjeko-ligjor mbi sëmundjen e tij të përhershme ose statusin si i verbër, invalid paraplegjik dhe tetraplegjik dhe jetimët.

4. Për të verifikuar rastet më emergjente sipas pikës 1 të këtij udhëzimi, shërbejnë treguesit e mëposhtëm:

- sipërfaqja për frymë faktike e banimit të mos jetë më shumë se 6 m² sipërfaqe banimi për person;

- pagesat e qirasë mujore të mos jenë më pak se 30 për qind të të ardhurave mujore;

- në rastet e divorcit, certifikata e gjendjes familjare duhet të jetë e datuar para hyrjes në fuqi të këtij udhëzimi.

5. Për familjet e evidencuara sipas pikës 1, organet e qeverisjes vendore dhe Enti Kombëtar i Banesave, përveç verifikimit të dokumentacionit, të kryejnë edhe verifikim në banesën ku jeton familja me qira. Këto të dhëna t’i dërgohen Ministrisë së Rregullimit të Territorit dhe të Turizmit brenda datës 30 korrik 2003, sipas tabelës bashkëlidhur për efekt llogaritjeje dhe planifikimi.

6. Për zbatimin e këtij udhëzimi, ngarkohen organet e qeverisjes vendore dhe Enti Kombëtar i Banesave.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

U D H Ë Z I M

PËR MËNYRËN E ZBATIMIT TË EKZEKUTIMIT TË DETYRIMEVE MBI SHUMAT E LLOGARIVE NË BANKA

Në mbështetje të nenit 600 të Kodit të Procedurës Civile dhe ligjit nr.8269, datë 23.12.1997 “Për Bankën e Shqipërisë”, Banka e Shqipërisë nxjerr udhëzimin me këtë përmbajtje:

Neni 1

Qëllimi

Qëllimi i këtij udhëzimi është përcaktimi i mënyrës së ekzekutimit të detyrimeve mbi shumat e llogarive në bankat e nivelit të dytë, në bazë të titujve ekzekutivë të përcaktuar në nenin 510 të Kodit të Procedurës Civile të Republikës së Shqipërisë.

Neni 2

Përkufizime

Sa herë që përdoren në këtë udhëzim, termat e mëposhtëm nënkuptojnë:

“Bankë”- personin juridik që kryen veprimtari bankare në Republikën e Shqipërisë, sipas licencës së dhënë nga Banka e Shqipërisë.

“Debitor”- çdo klient të bankës, që ka pranë saj llogari në emër të tij dhe kundrejt të cilit është lëshuar një kërkesë për vënie sekuestrore nga ana e përmblyesit gjyqësor.

“Llogari”- çdo llogari që përdoret nga klienti debitor në marrëdhëniet me bankën dhe që mund të përdoret për kryerje pagesash në ngarkim të debitorit: llogari rrjedhëse, krediti, depozite, llogari buxhetore etj.

“Vënie sekuestrore”- bllokimi i përkohshëm të shumave në llogari, me qëllim sigurimin e padisë, në përputhje me nenin 206 të Kodit të Procedurës Civile;

dhe/ose

nxjerrjen e shumave nga llogaritë dhe kalimin e tyre në llogarinë e përmblyesit gjyqësor, në zbatim të neneve 510 dhe 511 të Kodit të Procedurës Civile.

Neni 3

Detyrimi i bankave për të bllokuar llogaritë dhe për të informuar zyrën e përmblyesit

3.1 Në zbatim të neneve 593 dhe 594 të Kodit të Procedurës Civile, zyra e përmblyesit ka të drejtë të kërkojë të informohet dhe të urdhërojë bllokimin e llogarive të debitorit në të gjitha bankat që ushtrojnë veprimtarinë e tyre në Republikën e Shqipërisë.

3.2 Kërkesa/urdhri për informimin dhe bllokimin e llogarisë paraqitet në formën zyrtare dhe duhet të përmbajë minimalisht:

a) Të dhëna të sakta për identifikimin e klientit:

- emrin, mbiemrin, atësinë, datëlindjen dhe adresën e banimit (për individët);

- emërtimin dhe numrin e vendimit të regjistrimit në regjistrin tregtar (për personat fizikë dhe për shoqëritë tregtare);

- emërtimin, si dhe numrin e aktit përkatës për njohjen e personalitetit juridik (për personat e tjerë juridikë).

- b) Shumën maksimale të detyrimit për t'u paguar.
- c) Afatin e vlefshmërisë për bllokimin e llogarisë.

3.3 Banka është e detyruar menjëherë, por jo më vonë se 10 ditë kalendarike nga marrja e kërkesës/urdhrit:

a) të informojë me shkrim zyrën e përmbartimit dhe të bllokojë llogarinë e debitorit deri në shumën e kërkuar;

b) të informojë me shkrim zyrën e përmbartimit për rastet kur klientët nuk kanë llogari pranë saj.

3.4 Në zbatim të pikës 3.2 të këtij neni, Drejtoria e Përgjithshme e Përmbartimit nxjerr formën standarde të urdhrit të bllokimit, një kopje e të cilës mund t'i dërgohet bankave për dijeni paraprakisht.

Neni 4

Kërkesat që duhen plotësuar për vënien e sekuestros

4.1 Në zbatim të nenit 527 dhe të nenit 594 të Kodit të Procedurës Civile, banka vë sekuestron mbi llogarinë e debitorit, deri në masën e nevojshme për ekzekutimin e detyrimit, kundrejt paraqitjes nga zyra e përmbartimit të këtyre dokumenteve:

a) Kërkesa/urdhri i zyrës së përmbartimit për vendosjen e masës së sekuestros me të dhënat e nevojshme për identifikimin e debitorit dhe destinacionin e shumës së sekuestruar dhe që duhet të përmbajë:

- të dhënat për identifikimin e debitorit, sipas përcaktimit të bërë në shkronjën (a) të pikës 3.2 të këtij udhëzimi;

- shumën e saktë të këtij detyrimi;

- të dhënat e sakta për emërtimin, numrin e llogarisë dhe bankën për kalimin e shumës së sekuestruar;

- radhën e preferimit, në zbatim të nenit 605 të Kodit Civil.

Në zbatim të kësaj pike Drejtoria e Përgjithshme e Përmbartimit nxjerr formën standarde të urdhrit të sekuestrimit, një kopje e të cilës mund t'u dërgohet bankave për dijeni paraprakisht.

b) Vendimi gjyqësor, si dhe çdo akt tjetër, i cili në zbatim të nenit 510 të Kodit të Procedurës Civile konsiderohet titull ekzekutiv.

c) Dokumenti që vërteton lajmërimin e debitorit për ekzekutimin vullnetar të detyrimit dhe për marrjen dijeni nga ana e tij.

4.2 Dokumentet që i dërgohen bankës janë sipas rastit origjinale, ose të noteruara, ose të vërtetuara "njësia me origjinalin" nga sekretaria e gjykatës, ose fotokopje të vërtetuara me vulën e zyrës së përmbartimit.

4.3 Kërkesa/urdhri për vënie në sekuestro mund të bëhet edhe pa zbatuar nenin 3 të këtij udhëzimi, në rastet kur zyra e përmbartimit ka dijeni të plotë për ekzistencën e llogarive të debitorit dhe nuk e gjykon të nevojshme marrjen e informacionit.

Neni 5

Procedura e vënies së sekuestros

5.1 Banka kontrollon dokumentacionin e paraqitur dhe në rast se konstaton mangësi, në formë ose në përmbajtje, praktika i kthehet zyrtarisht zyrës së përmbartimit me vërejtjet e konstatuara, jo më vonë se tre ditë-pune nga dita e mbërritjes së tyre në bankë, ndërsa llogaria e debitorit mbahet e bllokuar edhe 10 ditë kalendarike të tjera nga dita e nisjes së përgjigjes, në pritje të rregullimit të mangësive nga zyra e përmbartimit. Në mungesë të përgjigjes nga ana e zyrës së përmbartimit brenda këtij afati, kërkesa/urdhri për sekuestrim konsiderohet se nuk është bërë.

5.2 Në rastet kur dokumentacioni i paraqitur konsiderohet i rregullt, banka vë sekuestron në llogarinë e debitorit, jo më vonë se tre ditë-pune nga dita e marrjes së kërkesës/urdhrit për sekuestro.

5.3 Vënia e sekuestros dhe/ose bllokimi i llogarisë së debitorit, nuk pezullon pagimin e kredive që, sipas nenit 605 të Kodit Civil paguhen me preferim ndaj kërkesës/urdhrit për sekuestro. Kur shuma e llogarive nuk është e mjaftueshme për të shlyer detyrimet e paraqitura për ekzekutim, banka njofton përmbartuesin gjyqësor, i cili respekton radhën e preferimit që përcaktohet në nenin 605 të Kodit Civil.

5.4 Në rastet kur shuma e disponueshme në llogari në ditën e kryerjes së veprimeve, në përputhje me pikën 5.2 të këtij neni, nuk është e mjaftueshme për të plotësuar të gjithë shumën e detyrimit, veprohet për vënien e sekuestros pjesore deri në shumën e disponueshme në llogari të saj.

5.5 Me vënien e sekuestros pjesore në llogari, praktika konsiderohet e mbyllur për bankën dhe informohet zyra e përmbarrimit sipas rastit, zyrtarisht ose me kreditimin e llogarisë së saj.

5.6 Zyra e përmbarrimit ka të drejtë të rikërkojë vënien në sekuestro për praktikën e kthyerë me të njëjtën bankë ose me banka të tjera, duke e nisur praktikën nga e para deri në përmbarrimin e plotë të detyrimit, duke zbatuar të gjitha kërkesat e parashikuara në nenin 4 të këtij udhëzimi.

5.7 Kur banka është në pamundësi për vënien e sekuestros në afatin e parashikuar në pikën 5.2 të këtij neni, tërësisht ose pjesërisht për mungesë gjendjeje ose për shkak preferimi në zbatim të nenit 605 të Kodit Civil, ajo e kthen praktikën pa veprim dhe njofton zyrën e përmbarrimit, jo më vonë se dy ditë-pune, pas mbarimit të afatit kreditor të përcaktuar në pikën 5.2 të këtij neni.

Neni 6

Procedura për pezullimin e ekzekutimit të kërkesës/urdhrit

6.1 Pezullimi i kërkesës/urdhrit për vënie sekuestro bëhet vetëm kundrejt paraqitjes së vendimit të gjykatës për pezullimin e gjykimit, në përputhje me nenin 297 të Kodit të Procedurës Civile.

6.2 Vendimi për pezullimin e gjykimit mund të paraqitet në bankë nga zyra e përmbarrimit ose nga debitori ose përfaqësuesi i autorizuar prej tij.

6.3 Me marrjen e vendimit për pezullimin e gjykimit nga debitori ose nga përfaqësuesi i autorizuar i tij, banka njofton menjëherë zyrën e përmbarrimit, por jo më vonë se tre ditë-pune nga marrja e tij.

6.4 Pezullimi nuk ka pasojë heqjen e masës së bllokimit sipas kërkesës/urdhrit të zyrës së përmbarrimit, në kuptimin e nenit 3 të këtij udhëzimi.

6.5 Afati për pezullimin e urdhrit dhe bllokimi i llogarisë vazhdon deri në përfundimin e procesit të rigjykimit nga gjykata.

Neni 7

Verifikimi i dokumentacionit bankar nga përmbarruesi gjyqësor

7.1 Në kuptim të nenit 598 të Kodit të Procedurës Civile, përmbarruesi gjyqësor ka të drejtë të verifikojë në vend dokumentacionin bankar në prani të punonjësit të ngarkuar nga administratorët e bankës, kur ai ka bazë të dyshojë se banka:

- nuk ekzekuton pa arsye detyrimin tërësisht ose pjesërisht;
- shkel afatet e ekzekutimit;
- nuk respekton radhën e preferimit.

7.2 Verifikimi i kryer në kuptimin e këtij neni, dokumentohet me procesverbalin e rastit, një ekzemplar i të cilit mbetet në bankë.

Neni 8

Dispozitat e fundit

8.1 Me zbatimin e këtij udhëzimi ngarkohen të gjitha bankat dhe degët e bankave në Republikën e Shqipërisë.

8.2 Të gjitha bankat dhe degët e bankave, subjekte të këtij udhëzimi, detyrohen të afishojnë këtë udhëzim në sportelet e tyre.

8.3 Me hyrjen në fuqi të këtij udhëzimi, udhëzimi “Për mënyrën e zbatimit të ekzekutimit të detyrimeve mbi shumatat e llogarive e depozitave në banka” miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë nr.39, datë 31.3.1999, shfuqizohet.

8.4 Ky udhëzim u miratua me vendimin nr.43, datë 11.6.2003 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë dhe hyn në fuqi 15 ditë pas botimit të tij në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Shkëlqim Cani

SHPALLJE KËRKESE PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Ministria e Rregullimit të Territorit dhe e Turizmit shpall kërkesën për shpronësim për interes publik të objektit “Rikonstruksion i varrezave të Sharrës në Tiranë”.

Subjekti kërkues i këtij objekti është Bashkia Tiranë.

Me anë të këtij publikimi kërkojmë të vëmë në dijeni personat të cilët preken nga ky shpronësim. Vënia në dijeni konsiston në masën e vlerësimit të llogaritur nga komisioni i shpronësimit pranë Ministrisë së Rregullimit të Territorit dhe të Turizmit, për secilin person sipas listës emërore të mëposhtme.

Ky publikim do të jetë me periudhë një javore dhe brenda 15 ditëve nga plotësimi i këtij afati për publikim, personat që kanë emrat në listën emërore kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre të shoqëruara me dokumentet përkatëse në ministrinë kompetente (Ministria e Rregullimit të Territorit dhe e Turizmit).

Nr.	Emri Mbiemri	Sip. toke m/2	Njësia lekë m/2	Vlera lekë
1.	Ramiz Muça	805	2 000	1 610 000
2.	Ndriçim Bakalli	75	2 000	150 000
				1 760 000

V E N D I M (I SHKURTUAR)

Gjykata e Shkallës së Parë Tiranë, me vendimin nr.4895, datë 11.12.2002, ka shpallur të zhdukur shtetasin Liman Bajram Spahiu, i datëlindjes 1941, lindur në Burrel dhe banues në Tiranë.

V E N D I M (I SHKURTUAR)

Gjykata e Shkallës së Parë Tiranë me vendimin nr.2297, datë 26.5.2003 ka shpallur të zhdukur shtetasin Paqësor Dilaver Ismailaj, banues në Tiranë.

KËRKESE

Shtetasja Sybe Hida, banuese në Bathore, Komuna Kamëz, kërkon shpalljen të zhdukur të bashkëshortit të saj Leonidha Hida.

KËRKUESE
Zybe Hida

Fletorja Zyrtare gjendet:

- në çdo njësi postare të çdo qyteti;
 - pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare:
- Rr. Qemal Stafa, pranë ndërtesës së Prokurorisë së Përgjithshme.

Pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare mund të gjeni:

Kodi Penal <i>Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare</i> Mars, 2002	Kodi i Procedurës Penale <i>Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare</i> Shtator, 2002	Kodi i Procedurës Civile <i>Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare</i> Korrik, 2002	Kodi Rrugor <i>Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare</i> Qershor, 2002
Kodi Penal Ushtarak <i>Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare</i> Tetor, 2002	Përmbledhëse legjislacioni në fushën e Përmbarimit <i>Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare</i> Tetor, 2002		

Doli nga shtypi më 21.6.2003

Tirazhi: 4300 copë

Formati: 60x88/8

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2003

Çmimi: 150 lekë